



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME

Numri i lëndës: 2023:056749
Datë: 12.09.2023
Numri i dokumentit: 04669786

Pml.nr.472/2023

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Valdete Daka kryetare e kolegjit, Agim Maliqi dhe Afrim Shala, anëtarë, me bashkëpunëtoren profesionale Qefsere Berisha, procesmbajtëse, në çështjen penale ndaj të pandehurit K. D., për shkak të dyshimit të bazuar se ka kryer veprën penale “Fajdeja” nga neni 331, paragrafi 3. lidhur me paragrafin 1. të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), duke vendosur lidhur me kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtëses së të pandehurit, avokate Shemsije Asllani, të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj - Departamenti për Krime të Rënda 2023:175071 të datës 21 gusht 2023 dhe aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës - Departamenti për Krime të Rënda PN1.DKR.nr.923/2023 të datës 30 gusht 2023, në seancën e kolegjit të mbajtur më 12 shtator 2023, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. Me miratimin e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtëses së të pandehurit K. D., anulohen aktvendimi i Gjykatës Themelore në Ferizaj - Departamenti për Krime të Rënda 2023:175071 i datës 21 gusht 2023 dhe aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës - Departamenti për Krime të Rënda PN1.DKR.nr.923/2023 i datës 30 gusht 2023, dhe çështja i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rivendosje.

II. I pandehuri mbetet në paraburgim deri në marrjen e një vendimi të ri.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Ferizaj - Departamenti për Krime të Rënda, me aktvendimin 2023:175071 të datës 21 gusht 2023, të pandehurit K. D., për shkak të dyshimit të bazuar se ka kryer veprën penale "Fajdeja" nga neni 331, paragrafi 3. lidhur me paragrafin 1. të KPRK, i është vazhduar masa e paraburgimit në kohëzgjatje prej 2 (dy) muajve dhe atë duke filluar nga data 21 gusht 2023 deri më 20 tetor 2023. Të pandehurit paraburgimi i është vazhduar konform dispozitës së nenit 184, par. 1., nën par. 1.1, e 1.2, nën paragrafi 1.2.1., 1.2.2. dhe 1.2.3, të Kodit të Procedurës Penale (KPP).

Në procedurën ankimore, Gjykata e Apelit e Kosovës - Departamenti për Krime të Rënda, me aktvendimin PN1.DKR.nr.923/2023 të datës 30 gusht 2023, e ka refuzuar si të pabazuar ankesën e mbrojtëses së të pandehurit dhe e ka vërtetuar aktvendimin e shkallës së parë.

Kundër këtyre aktvendimeve, kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë ka ushtruar mbrojtësja e të pandehurit K. D., avokate Shemsije Asllani, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të KPP, vendimit mbi vazhdimin e paraburgimit dhe për shkak të vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike, me propozim që kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë të aprovohet si e bazuar, aktvendimet e kundërshtuara të ndryshohen, të pandehurit t'i ndërpritet masa e paraburgimit ose t'i caktohet ndonjë masë tjetër më përshtatshme nga neni 171, paragrafi 1. pika 1.5, 1.6, dhe 1.7. të KPP.

Kryeprokurori i shtetit, me shkresën KMLP.III.nr.197/2023 e datës 7 shtator 2023, ka propozuar që kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtëses së të pandehurit, të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit shqyrtoi shkresat e lëndës në kuptim të nenit 435, paragrafi 1. lidhur me nenin 436, paragrafi 1. të KPP, vlerësoi pretendimet në kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë, përgjegjës në kërkesë dhe gjeti se:

- kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë është e bazuar.

Mbrojtësja e të pandehurit, në kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë thekson se aktvendimi i gjykatës së shkallës së parë dhe gjykatës së shkallës së dytë nuk përmbajnë arsyetim konkret lidhur me bazat ligjore për të cilat të pandehurit i është vazhduar masa e paraburgimit. nuk janë dhënë arsye konkrete dhe specifike lidhur me mundësinë e ikjes, arratisjes apo fshehjes, mundësia e ndikimit në dëshmitarë apo të dëmtuar, pa i specifikuar ata, nëse ka pasur kërcënim nga kush drejtuar kujt, nuk ka të kaluar kriminale, përkundrazi dëshmitarët – të dëmtuarit janë me të kaluar kriminale. I pandehuri është intelektual, veprimtarinë e tij e ushtron që 7 vite dhe përkundrazi ai është i dëmtuar dhe se si drejtor i Autosallonit "A. R.", me korrektësi ka ushtruar veprimtarinë e tij. Prokuroria nuk ka ofruar prova të mjaftueshme për të për të mbështetur pretendimet se të pandehurit duhet ti vazhdohet paraburgimi. Sa i përket mundësisë së ndikimit në dëshmitarë, pasi që disa të pandehur i kanë kërcënuar të dëmtuarit që t'i paguajnë fajdet, nuk qëndron pasi që i pandehuri nuk mund të paragjykohet për veprimet e të pandehurve tjerë në këtë çështje penale, duke cekur gjithashtu se të gjithë të pandehurit përgjigjen personalisht për veprën penale.

Gjykata Supreme e Kosovës, vlerëson se janë të bazuara pretendimet e mbrojtëses së të pandehurit, se aktvendimet e kundërshtuara janë të përfshira me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384, par. 1 nën par. 1.10 të KPP, pasi që aktvendimeve të gjykatave të instancave më të ulëta u mungon arsyetimi. Gjykata e shkallës së parë, më pas edhe gjykata e shkallës së dytë nuk kanë bërë përshkrimin e provave, respektivisht nuk kanë dhënë arsye dhe nuk i kanë specifikuar rrethanat dhe provat konkrete për rrezikun apo mundësinë e

ndikimit në dëshmitarë dhe të dëmtuar, të cilët duhet caktuar me emër dhe mbiemër, si dhe në rrezikun e përsëritjes së veprës penale konform nenit 184, paragrafi 1. nën paragrafi 1.1. e 1.2. pikat 1.2.1, 1.2.2, dhe 1.2.3. të KPP, për të cilat baza i është vazhduar të pandehurit masa e paraburgimit. Në aktvendimet e kundërshtuara vetëm janë parafrazuar dispozita ligjore e nenit 184. të KPP lidhur me kushtet e nevojshme për vazhdimin e paraburgimit pa i specifikuar ato më detajisht dhe më konkretisht, e të cilat fakte të specifikuar e të konkretizuara, do të arsyetonin dhe mbështesin rrezikun ikjes, ndikimit në dëshmitarë dhe rrezikun e përsëritjes së veprës penale.

Gjykata e shkallës së parë, me rastin e rivendosjes duhet t'i evitojë shkeljet e theksuara më lartë, në arsyetim duhet të jep arsye konkrete, përshkrimin e provave specifike që e mbështesin rrezikun e ikjes, arratisjes apo fshehjes, rrezikun e ndikimit në dëshmitarë-të dëmtuar, cilët të dëmtuar dhe dëshmitarë respektivisht të ceken me emër dhe mbiemër, mënyrën e kanosjes ndaj të dëmtuarve – dëshmitarëve, nëse ka pasur ndonjë rrezik të tillë, si dhe rrezikun e përsëritjes së veprës penale.

Po ashtu, gjykata e shkallës së parë duhet që më detajisht të arsyetojë mos aplikimin e masave alternative, të parapara me nenin 171. paragrafi 1. të KPP, sidomos kur mbrojtja propozon ndonjë masë, arsyetimi duhet të jetë më i detajuar dhe më konkret.

Gjykata Supreme e Kosovës, edhe me aktgjykimin Pml.nr.416/2023 të datës 18 gusht 2023, i ka dhënë vërejtjet dhe udhëzimet në këtë drejtim, të cilat gjykata e shkallës së parë nuk i ka zbatuar me rastin e marrjes së vendimit.

Nga sa u parashtrua më lartë e në kuptim të nenit 438, paragrafi 1. nën paragrafi 1.2. të KPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - PRISHTINË
Pml.nr.472/2023, më 12 shtator 2023

Bashkëpunëtorja profesionale,
Qefsere Berisha

Kryetarja e kolegjit,
Valdete Daka